



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD U PRIŠTINI – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.833/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të akuzuarit R. I. nga fshatin G.K.Lipjan, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.5005/16 të dt.05.12.2016, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.08.05.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurores Fatmire Cacaj, të pandehurit, dhe përfaqësueses së palës së dëmtuar B. Z., në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

R. I., nga i ati E., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në fsh. G. K. Lipjan, me numër personal *numri përsonal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 04.04.2016, i pandehuri në shtëpinë e tij për plotësimin e nevojave të tij, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, duke u lidhur përmes një kablle, në atë mënyrë që energjinë elektrike nuk është regjistruar, me ç,rast është shkaktuar dëm prej 1.653,46.-€.

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73 dhe nenit 320 të KPRK-së, si dhe dispozitave të nenit 365 të KPPK- së, të pandehurin e gjykon me,

DËNIM ME KUSHT DHE ME GJOBË

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprën tjetër penale, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 400.-€ (katërqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 46 par. 3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

DETYROHET i pandehuri që të dëmtuarës KEDS-it, Distribucioni të Furnizimit në Ferizaj, t'ia kompensojë shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 1.653,47-€, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të i'a paguajnë shumën prej 30-€, si dhe dhe shumën prej 30-€, për Fondin e Mbrojtjes së Viktimave të Krimin, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj, PP.II.nr.5005/16 të dt.05.12.2016, e ka akuzuar të akuzuarin R. I., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktit akuzues, të ushtruar kundër të pandehurit R. I., për veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, ngase gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë u vërtetua në bazë të provave të administruara materiale të propozuara me aktakuzë, si dhe në bazë të deklaratave të dëshmitarëve, dhe mbi bazën e këtyre thënieve kësaj gjykate i ka propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

E dëmtuara në fjalën përfundimtare e ka mbështetur fjalën e prokurorit të Shtetit dhe i është bashkangjitur ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe ka mbetur poashtu pranë kërkesës për shpërbllim të dëmit dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të denohet sipas Ligjit.

I akuzuari R. I. në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar aktakuzën e prokurorisë, dhe njëherit nga gjykata ka kërkuar që të njëjtin ta lirojë nga aktakuza.

Pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, gjyqtari i vetëm gjykues për të vërtetuar gjendjen faktike sa më mirë dhe sa më drejtë në këtë çështje juridiko-penale, në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e këtyre provave, me dëgjimin e dëshmitarëve H. S. dhe D. K., shiqimin dhe leximin e procesverbalit të dt. 04.04.2016, i hartuar nga puntorët e KEDS-it, me shiqimin e fotove që gjinden në shkresat e lëndës, me shiqimin dhe leximin e procesverbalit të dt. 07.10.2015, mbi ndrrimin e njëhsorit elektrik, me shiqimin dhe leximin e faturës të dt. 05.04.2016 së bashku me faturën tjetër të kalkulimit nga Departamenti për rikthimin e humbjeve i po të njëjtës datë, e të cilat prova gjyqtari i vetëm gjykues i administroi dhe i vlerësoi secilen veç e veç dhe në lidhje me të gjitha provat tjera, sikur ato që janë kundër të akuzuarit të njëjtat prova i vlerësoi njëjtë edhe ato në favor të tij, dhe pas vlerësimit me ndërgegjje të këtyre provave dhe në bazë të vlerësimit të lirë, e në vështrim të nenit 7 dhe nenit 361 të KPPK-së, vërtetoi këtë gjendje faktike:

- Se i pandehuri, me datë, kohë dhe vend të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, për të cilën akuzohet.

Gjykata nga dëshmia e dëshmitarit H. S. në procedurën e provave, vërtetoi se në ditën kritike gjatë kontrolles kemi pasur urdhëresë për kontroll, pasi paraprakisht është dyshuar për keqpërdorim dhe se njëhsori elektrik tek ky konsumator ka qenë i vendosur jashtë shtepisë, në shtyllën elektrike dhe pas verifikimit kemi konstatuar se ky njëhsor në KEDS, ka qenë i regjistruar në emrin e R. E. I., nga fshati G., dhe ne fillimisht i kemi ndaluar siguresat në njëhsor, dhe kemi kontrolluar rrymën, pastaj prapë ka vazhduar, e'që në atë moment është

dashur të ndalet kur ndërpriten siguresat, prapë kemi verifikuar në shtyllën elektrike se është bërë lidhje direkte jashtë pikes matëse, pastaj kemi shkuar në shtëpinë e të akuzuarit ku ka qenë një grua sa i kujtohet, dhe e njehta e ka thirrur në telefon, në atë moment ka qenë prezent djali i të akuzuarit, dhe e kemi njoftuar për të gjeturat dhe bashkë me të kemi hyr brenda dhe e kemi bërë verifikimin e paisjeve që kanë qenë duke u shfrytëzuar në shtëpinë e të akuzuarit. Në vazhdim dëshmitari ka shtuar se ato paisje i kemi regjistruar vetëm ato që kanë qenë të vendosura në prizmat që kanë pasur tension dhe jo të gjitha, pra në ato vende ku nuk është regjistruar energjia elektrike e që ka pasur tension (lidhje direkte). Në vazhdim dëshmitari ka shtuar se rryma vjen nga lartë të shtylla elektrike, dhe zbret poshtë në një distanc ku është i vendosur njehsori elektrik dhe pasi rryma hynë në njehsor dalja vazhdon me kablo ngritet lartë në shtyllen elektrike tek konsumatori në shtëpi pa ndërprerje, në rastin konkret kur dalja e kabllave nga njehsori është ngritur lartë në shtyllen elektrike në maje të shtyllës elektrike është prerë kabloja dalëse nga njehsori pjeserisht dhe është lidhur direkt në rrjetin që e furnizon fshatin për çka energjinë e shpenzuar në rastin konkret nuk vjen nga njehsori elektrik si i regjistruar, por vjen nga rrjeti i fshatit, për çka në këtë mënyrë kanë qenë të lidhura dy faza me tension, ndërsa njëra ka ardhur në mënyrë të rregullt nga njehsori elektrik, pra e gjitha shihet në fotot që janë në shkresat e lëndës.

Nga dëshmia e dëshmitarit D. K. gjykata vertetoi se me rastin e kontrollës dhe për shkak të humbjeve të energjisë që ka pas trafoja e fshatit, edhe pasi që paraprakisht janë konstatuar humbje, se te ky konsumator në vendngjarje kemi konstatuar se njehsori e ka të zhvendosur në shtyllen elektrike jashtë oborrit, dhe fillimisht e kemi hapur ormanin ku konsumatori e ka njehsorin të vendosur dhe kemi shkuar në atë shtyllë, ku kanë qenë dy njehsor elektrik, njëri i dikujt tjetër, dhe tjetri ka qenë i R. I., pra te ky i fundit ku pasi paraprakisht e kemi ndaluar rrymën në siguresa të njehsorit, dhe kemi shkuar te shtëpia e të akuzuarit, pastaj kemi shkuar te shtëpia, dhe e kemi lajmëruar në atë moment ka dalur një person mashkull i moshës madhore që besohet se ka qenë djali i tij, pasi kemi ndërpre rrymën në dalje të njehsorit elektrik ai konsumator nuk duhet të ketë rrymë në shtëpi, dhe e kemi pytur atë person a bon ta shiqojmë vendin ku ka qenë i vendosur njehsori elektrik, dhe në atë vend pasi kemi kontrolluar kemi vërejtur se ka tension, gjë që është dashur të mos ketë tension, dhe kemi vërejtur se diqka nuk është në rregull. Më tutje dëshmitari ka shtuar se për ta bindur konsumatorin i kemi tregu, që ta shiqon njehsorin elektrik që është i ndaluar në siguresa, dhe prapë ka rrymë në shtëpi, ai është deklaruar se nuk e di kush e ka bërë, dhe pastaj ne për të vërtetuar vendin e keqperdorimit jemi hipur në shtyllë elektrike dhe ku është konstatuar se dy fazat nga kabloja furnizuese që dalin nga njehsori ngriten nalt ne maje të shtyllës elektrike, pastaj vazhdojnë për në shtëpin e konsumatorit dhe në lartësin e shtyllës ku janë në afersi me tensionin tjetër të fshatit ku dy fazat kanë qenë të lidhura me kleme apo kafshuse të kyqura në kabllin furnizues të fshatit, për çka kjo i ka mundësuar shfrytëzimin e energjis pa rigjistrim në njehsorin elektrik .

Nga procesverbali i ekipës së KEDS-it i dt. 04.04.2016 po ashtu është vërtetuar nga ekipa e kontrollës ka konstatuar gjendjen në teren dhe pas kësaj në përfundim është konstatuar se ekipa e kontrollës në teren te i pandehuri është gjetur lidhje direkte me pastaj janë verifikuar paisjet elektrike, ku në shtëpin e të akuzuarit kishte gjetur paisjet që kishte

shfrytëzuar dhe ato ishin, thithse elektrike, bojler, lavatriqe, frigorifer dhe ndriqimi të cilin rast në bazë të paisjeve që ka shfrytëzuar është llogaritur edhe dëmi i të dëmtuarit, i cili është shkaktuar me qëllim të keqpërdorimit të energjisë elektrike.

Nga procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njëhsorit elektrik nr. *numri i njëhsorit...* të dt. 07.10.2015, është vërtetuar se në këtë kohë të akuzuarit i ishte bërë ndërrimi i njëhsorit elektrik dhe i është zhvendosur njëhsori i mëpushëm dhe i është vendosur njëhsori në shtyllë elektrike.

Nga leximi i faturës së KEDS-it , të dt. 05.04.2016 së bashku me faturën tjetër të kalkulimit nga Departamenti për rikthimin e humbjeve, gjykata konstatoi se i akuzuari i ka shkaktuar dëm KEDS-it, në vlerë prej 1.653,47-€, dëm ky i llogaritur mbi bazën e paisjeve elektrike që i janë gjetur në shtëpinë e të akuzuarit e të cilat kanë qenë të vendosura në prizma ku është keqpërdorur energjia elektrike.

Ndërsa lartësinë e dëmit material të cilin e ka shkaktuar e që është llogaritur nga e dëmtuara mbi bazën e llogaritjes së KW (kilovatëve) që janë identifikuar në njëhsorin e të dëmtuarit i cili është ankuar për hargjim të madh dhe faturim të dyfishtë të shpenzimeve, e mbi bazën e udhëzimeve respektivisht akteve normative mbi llogaritjen e dëmit të humbur me rastin e keqpërdorimit të energjisë elektrike e që mirret për bazë 6 muaj periodha mbrapa për persona fizik dhe kjo lartësi e dëmit prej 1.653.47-€ është vërtetuar në bazë të faturës së kalkulimit nga Departamenti për rikthimin e humbjeve të dt. 05.04.2016.

I akuzuari në këtë gjykatë ka deklaruar se i kundërshton deklaratat e dëshmitarve, duke mohuar faktin se me duket absurde nocioni i vjedhjes dhe thyse për mua dhe për personalitetin tim dhe të familjes sepse ngjarja për të cilin flitet qëndron rreth 80 metra largë shtëpisë sime dhe është fare e pa kontrolluar nga unë dhe familja ime sepse ajo është në një pozicion që është nën kontroll të fshatit, dhe unë nuk kam mundësi të nderhyjë dhe pa lejen time nuk do të guxonte dikush të nderyjë prandaj puntorët e KEDS-it, kanë kontrolluar dhe kanë kryer detyrën e tyre me perjashtim të nxemjes të cilën nuk e përdori për shkaqe të arsyeshme të gjitha paisjet tjera kanë qenë të kyqura ku kanë shpenzuar energji e cila është regjistruar në njëhsorin elektrik dhe këtë energji e kam shfrytëzuar çdo muaj. Në vazhdim i akuzuari ka shtuar se paisjet të cilat janë regjistruar nga puntoret e KEDS-it, të gjitha ka qenë të vendosura në rrjetin, ku është regjistruar energjia elektrike në mënyrë të zakonshme dhe jo jashtë lidhjes direkte, dhe i njëjti shton se nuk jam dijeni se cila paisje kanë qenë të lidhur në prizma elektrike, të cilat kanë qenë jashtë pikes matse, nuk kam pasur paisje të cilat kanë me shpenzuar energji dhe nuk është regjistru energjia elektrike, dhe i njëjti shton se jam pagues i rregullt i energjisë elektrike ku për çdo muaj kam paguar 50, 55 deri në 60 euro në muaj. Po ashtu i njëjti ka deklaruar se une nuk kam bërë lidhje direkte, dhe askush nuk ka mundur ta bëjë pa lejen time, i akuzuari deklaron se për fazat e lidhura në lartësi të shtyllës elektrike nuk kam qenë në dijeni. Dhe në fund i njëjti faleminderohet për zgjidhjen e këtij problemi dhe për heqjen e kësaj dileme që është bërë kjo lidhje pa dijenin time.

Pra, nga provat e administruara më lartë të cilave gjykata ia fali besimin me padyschim vërtetohet se i pandehuri në datë, kohë dhe vend të caktuar, me dashje ka kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit dhe me veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, dhe se në rastin konkret nuk ekzistojnë rrethana të cilat do ta zvogëlonin apo përjashtonin përgjegjësinë penale të t'akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se i akuzuari është penalisht

përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohet, andaj të njëjtin e shpalli fajtores dhe e dënoi sipas ligjit.

Gjykata me rastin e vendosjes vlerësoi mbrojtjen e paraqitur nga ana e të akuzuarit, mirëpo të njëjtën mbrojtje e refuzoi si të pabazuar me arsyetimin se i akuzuari me asnjë provë nuk e argumentoi të kundërtën nga ajo siq është vërtetuar me provat e administruara por vetëm u mundua të paraqesë një gjendje tjetër faktike të pabazuar vetëm për t'iu shmangur përgjegjësisë penale.

Me rastin e vendosjes se llojit të denimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese për të pandehurin vlerësoi sjelljen e mëparshme të kryerësit, pra faktin se i njëjti për herë të parë është ndeshur me ligjin, rrethanat personale se i njëjti është mbajtur në familje, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale se i njëjti pas kryerjes së veprës penale më asnjëherë nuk është ndeshur me ligjin, shkallen e vogël të rrezikshmërisë së veprës penale ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të t'akuzuarit ashtu që i akuzuari është i moshës madhore dhe me profesion gazetar që më së miri është dashur ta kuptoj sjelljen e papërgjeshme të veten ndaj të njëjtit i shqiptoi dënim në përputhshmëri me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 dhe 50 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor u bazua në nenin 450 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ashtu që gjykata e detyroi të akuzuarin t'ia paguajë kësaj gjykate në emër të shpenzimeve për paushall gjyqësor shumë prej 30-€, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e Financimit të Kompensimit të Viktimave të Krimit bazohet në nenin 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike gjithashtu u bazua në dispozitën e nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.

P.nr.833/16 dt.05.12.2016

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.